



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA IV**

**Sesioni vjeshtor**

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës  
Mbledhja nr. 94  
Prishtinë, më 6.12.2013, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE  
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Ganimete Musliu, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Rasim Demiri dhe Danush Ademi.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Dhurata Kryeziu-OSBE, Sanije Berisha-OSCE, Venera Gashi-praktikante.

**Nga Stafi Mbështetës i Komisionit:** Nur Çeku, Haxhi Xhemajli, Zarife Aliu dhe Antingona Ibraj.

**Mbledhjen e kryesoi:** Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 22.11.2013;
3. Shqyrtimi i raporteve nga Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës dhe EULEX-i;
4. Të ndryshme.

**Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

### **1. Miratimi i rendit të ditës;**

**Kryetari i Komisionit** konstatoi miratimin e rendit të ditës.

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

Fillimisht shprehu ngushëllimet për vdekjen e ish- drejtorit të GIZ-it për Kosovë dhe Maqedoni, z. Michael Nebelung, i cili është vrarë nga sulmi i grupeve radikale në Jemen.

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.11.2013;**

**Kryetari i Komisionit** – Konstatoi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mbajtur, më 22.11.2013.

*Procesverbali u miratua me vërejtje.*

### **3. Shqyrtimi i raporteve nga Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës dhe EULEX-i;**

**Kryetari i Komisionit** - Nga Policia e Kosovës është kërkuar informatë për rrjedhën e ngjarjeve në zgjedhjet e 3 dhe 17 nëntorit si dhe 1 dhjetorit dhe për këtë çështje ata janë përgjigjur.

Nga reagimi ynë se nuk ka pasur gatishmëri të mjaftueshme të Policisë së Kosovës, për tu ballafaquar me rendin dhe qetësinë publike në tre vendvotime në Mitrovicën e veriut. Është ngritur niveli i gatishmërisë i PK-së, EULEX-it dhe mekanizmave të sigurisë, ashtu siç është kërkuar dhe më 17 nëntor kemi pasur një angazhim më efikas dhe zgjedhjet kanë shkuar në mënyrë të rregullt.

Për mbajtjen e zgjedhjeve më 1 dhjetor 2013, Policia e Kosovës është përgjigjur dhe janë përgatitur me rastin e zgjedhjeve në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, dhe me aq sa jemi në dijeni nuk ka pasur probleme gjatë zhvillimit të zgjedhjeve të 1 dhjetorit dhe raportet e paraqitura i janë përmbajtur kërkesave tona. Më pas e hapi debatin për raportet që janë në rend të ditës.

**Fatmir Xhelili**- Falënderoi misionin EULEX-it për gatishmërinë për të informuar Komisionin, sa herë që kërkohet një gjë e tillë dhe se ky falënderim përveç publikisht duhet të bëhet edhe me shkrim.

Raporti i Policisë së Kosovës përfshinë të gjithë atë çfarë është për tu shpjeguar një ngjarje apo zhvillimin e asaj që ka ndodhë në Mitrovicën e veriut dhe për këtë i falënderoj.

**Rexhep Selimi** - Kërkoi që të cilësohet, nëse janë raporte apo informata, siç i kemi kërkuar, pasi në rend dite janë si raporte. Raporti informues i MPB-së shpjegon disa gjëra që kanë ndërmend

t'i ndërmarrin. Data e raportit është 27.11.2013, ndërsa vonesa e pranimi të tij bën që pas datës së mbajtjes së zgjedhjeve të shohim se çfarë kanë ndërmarrë.

**Kryetari i Komisionit** - Ne kemi kërkuar informata dhe si të tilla kanë ardhur. Në rend dite janë si raporte por e rëndësishme është që janë përgjigjur. Informatën e kemi pranuar me më 29.11.2013 dhe ajo është dhënë me kohë, por për shkak të festës së 28 nëntorit, nuk është mbajtur mbledhja dhe shqyrtimi i kësaj informate është bërë me vonesë nga ana jonë.

Vlerësimet tona janë se, përgatitjet që janë përshkruar në informatë kanë dalë të sakta dhe Policia e Kosovës e ka kryer obligimin e vet në të gjitha vendvotimet për mbrojtjen e rendit dhe qetësisë publike.

Ndërsa, sa i përket informatës së IPK-së, rreth rastit të paraqitur nga z. Marinković, informata është sjell bashkë me një ankesë e cila është dorëzuar në IPK.

Sipas informatës që ne posedojmë nga IPK, ata arsyetohen se kjo ankesë është dërguar në Drejtorinë e Hetimeve të Brendshme, për hetime të mëtutjeshme disiplinore. Derisa nuk ka epilog, propozoj që ne të kërkojmë nga IPK-ja dhe Drejtoria e Hetimeve të Brendshme, të kryej detyrën e vet për këtë rast, dhe pastaj mund të kemi konstatimet tona si Komision.

**Goran Marinković**- Falënderoi IPK-në për informatën e paraqitur në formë të shkruar. Nga kjo informatë shihet që zyrtari i IPK-së z. Zhivorad Jovanović, me të cilin edhe unë kam kontaktuar, deklarata e tij është ashtu siç më ka thënë edhe mua, sepse qytetarët e Graçanicës nuk kanë pasur besim të ankohen tek zyrtarët policorë, prandaj më është dashur mua vet të kontaktoj drejtorin atje dhe i cili na ka sugjeruar që për këtë çështje ti drejtohem Inspektoratit Policor.

Gjithashtu i falënderoj për punën e shpejt të cilën e bëjnë dhe po ashtu shpresoj se nëse policët janë vërtetë të fajshëm të përgjigjen për veprimet që kanë bërë. Këtë besoj që hetimet e brendshme të IPK-së do ta dëshmojnë.

Po ashtu po e shoh në raport që janë thirrur në nenin 2, të ligjit për IPK-në, ku thuhet se të gjithë duhet të trajtohen njësoj dhe se policia është apartiake dhe se duhet të ketë për detyrë mbrojtjen e të gjithë qytetarëve që është edhe qëllimi i ligjit. Do të doja që kjo të jetë kështu dhe që fajtorët pa dallim, të përgjigjen për veprimet e tyre apo mosveprimet.

Në fund falënderoj IPK-në për informatën e shpejt dhe shpresoj që kjo të ndikoj në punën e mëtutjeshme të stacionit policor në Graçanicë, sepse atje kemi një numër të ankesave nga qytetarët për policinë.

**Fatmir Xhelili**- Konsideroj se është koha e fundit që të flasim me emër dhe mbiemër, duke mos përgjithësuar, pasi institucioni i Stacionit Policor është pjesë e strukturës së Policisë së Kosovës dhe duhet të kemi argumente të shumta për të folur në shumës, për të vlerësuar nëse një institucion punon mirë ose jo .

Për këtë arsye vlerësoj se individët mund të jenë fajtorë në sjellje dhe në përdorimin e tepruar të forcës ose sjellje jo adekuate ndaj qytetarëve apo deputetëve, prandaj vlerësoj se është më mirë të flitet në njëjës për personat që mund të kenë shkelur ligjin, por jo në shumës.

**Goran Marinković-** Konsideroj se nuk e kemi etiketuar policinë por kemi rastin kur është shkelur detyra zyrtare.

**Kryetari i Komisionit-** Pas rezultateve të Drejtorisë për Hetime të Brendshme në kuadër të IPK-së, mund të kemi vlerësimin si Komision.

Ndërsa sa i përket informatës së pranuar nga misioni EULEX, përgjigjja e tyre ndaj Komisionit është bërë më 27 nëntor dhe në këtë informatë janë shpjeguar momentet kur Policia e Kosovës ka kryer obligimin e saj me 3 nëntor, përveç në rastin kur janë demoluar tre vendvotime, ku EULEX-i thekson se ka rol këshillëdhënës, përkrahës dhe se mund të reagojë në fazën e dytë pas Policisë së Kosovës.

Gjithashtu theksohet se tutje në bashkëveprim me Policinë e Kosovës, KFOR-in dhe instrumentet e tjera të sigurisë, kanë ndërmarrë të gjitha masat që me 17 nëntor dhe 1 dhjetor, të mos përsëriten raste të tilla.

Përveç vonesës në pranimin e informatës, falënderojmë EULEX-in për informatën dhe konsideroj se kjo informatë është në vijën e kërkesës sonë.

**Rexhep Selimi-** Është lajm i mirë që EULEX-i ka sjellë këtë informatë dhe duhet vlerësuar. Pa dashur të hyj në misionin e përgjithshëm që ka EULEX-i në Kosovë, konsideroj se do të ishte mirë që me këtë hap EULEX-i, ti përgjigjet institucioneve të zgjedhura të Republikës së Kosovës, gjë që nuk ka ndodhur më herët, por është pozitive që të paktën simbolikisht i raporton institucioneve të zgjedhura të Kosovës.

**Kryetari i Komisionit-** Pasi vlerësua informatat e Policisë së Kosovës, IPK-së dhe EULEX-it, konsiderojmë se sa i përket aspektit të sigurisë, zgjedhjet lokale kanë kaluar në frymën e mirë, me përjashtim të disa incidenteve të izoluar.

#### **4. Të ndryshme.**

**Kryetari i Komisionit-** Me rastin e amendamentimit të buxhetit të Republikës së Kosovës, propozoj që si Komision të realizojmë një takim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, në mënyrë që të shikohet, nëse agjencitë që mbikëqyrën nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, janë të kënaqura me buxhetin e tyre.

Kemi pranuar një kërkesë për buxhet shtesë nga Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe krahas kësaj duhet të jetë angazhimi ynë si Komision për këto agjenci.

**Rexhep Selimi-** Sa i përket mbështetjes për Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, konsideroj se me një angazhim të plot të Komisionit do të mund të bënim zgjidhje për këtë institucion, pasi dihet që kanë problem me akomodimin e tyre në institucion publik. Prandaj si Komision kemi rol kyç në ndërmjetësimin gjatë amendamentimit të projektligjit për buxhetin e vitit të ardhshëm.

**Kryetari i Komisionit-** Prandaj konsideroj se takimi për këtë çështje do të ishte i dobishëm, në mënyrë që të vlerësohen nevojat financiare të institucioneve që mbikëqyrin, në mënyrë që të mund të bëhen ndërhyrje gjatë amendamentimit të projektligjit për buxhetin e vitit 2014.

Sa i përket Projektligjit për menaxhimin e emergjencave, grupi punues ka dal me amendamente si dhe të vlerësohen amendamentet e propozuara nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe më pas ato të aprovohen në Komision.

Deri më 25 dhjetor duhet të përgatitet raporti vjetor i punës për vitin 2013, si dhe një draft plan të punës për vitin 2014. Kjo do të bëhet në bashkëpunim me administratën dhe organizatat që mbështesin punën e Komisionit.

**Anton Quni-** Në mediat elektronike është duke qarkulluar një lajm që ka karakter shqetësues, dhe ka të bëjë me një pronar të një portali, i cili pretendon se ka qenë i shantazhuar, kërcënuar dhe në një formë i kidnapuar nga zyrtarët e Agjencisë të Intelgjencës së Kosovës .

Sipas tij, ai rastin e ka paraqitur në polici, se cila është e vërteta ne akoma nuk e dimë. Ndoshta mund të jetë e paraparë që të atakohet kredibiliteti i këtij institucioni, por sidoqoftë është mirë që të kemi informata konkrete nga autoritetet e Policisë së Kosovës, pasi sipas tij, ky rast është paraqitur në polici dhe nëse është paraqitur të dimë se si po trajtohet.

Pasi çështja është e karakterit sensitiv, propozoj që të takohet Kryetari i Komisionit për AKI-në, nëse ata e posedojnë këtë informatë dhe si mendojnë të trajtojnë këtë rast, nëse do të ketë nevojë për bashkëpunim për mbikëqyrjen zbatimit të ligjit dhe nëse ka pasur parregullsi në autorizimet e AKI-së.

**Kryetari i Komisionit-** Me miratimin tuaj do ta takoj Kryetarin e Komisionit për Mbikëqyrjen e AKI-së dhe një kërkesë drejtuar Policisë së Kosovës dhe më pas do të dimë detajet.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroj mbledhjen të përfunduar.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

**Përgatitur nga:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

**Kryetari i Komisionit**

---

**Ahmet Isufi**